



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo

RAPORT

për

PUNËTORINË KONSULTATIVE ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË



Burimi: Clker

Mars 2018

Zbatuar nga



Përmbledhje e punëtorisë	2
Gjetjet nga anketa online.....	2
Gjetjet nga grupet punuese	4
RINIA DHE VULLNETARIZMI	4
ARSIMI DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE.....	5
SHËRBIMET SOCIALE	6
EKONOMIA SOCIALE	7
MBROJTJA E MJEDISIT / MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETËSIA	8
PAJTIMI DHE DIALOGU KULTUROR.....	9
DEMOKRACIA DHE QEVERISJA E MIRË.....	10
Pjesëmarrësit në punëtori	11
Fotografi nga punëtorja	13

Përmbledhje e punëtorisë

Si pjesë e projektit "Përkrahja e Zhvillimit të Qëndrueshëm Organizativ të OSHC-ve në Kosovë", një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) dhe Instituti për Politikat e Zhvillimit (INDEP) organizuan punëtorinë konsultative me mbi 50 Organizata të Shoqërisë Civile në Kosovë.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte identifikimi i: problemeve kryesore me të cilat përballen OSHC-të në fushat përkatëse ku fokusohet puna e tyre; palëve relevante të interesit; kontributit të mundshëm të organizatave individuale në adresimin e çështjeve të ngutshme; si dhe i mundësive për krijimin e koalicioneve ndërmjet OSHC-ve për t'i adresuar së bashku këto çështje. Për më tepër, duke punuar së bashku në shtatë grupe të ndryshme punuese, OSHC-të pritej të gjeneronin ide dhe zgjidhje afatgjata për problemet kryesore që karakterizojnë një sektor të caktuar.

Pjesëmarrësit identifikuan çështjet kryesore në shtatë fusha prioritare nga 10 të përzgjedhura fillimisht, të cilave u është dhënë përparësi bazuar në gjetjen e anketës online të shpërndarë nga organizatorët përpara punëtorisë.

Gjetjet nga anketa online

Punëtorja u parapri nga një pyetësor online i dizajnuar për identifikimin e fushave prioritare me interes më të lartë për OSHC-të në Kosovë dhe me të cilat lidhet kryesisht puna e tyre. Gjetjet e këtij pyetësori shërbyen si bazë kryesore për diskutimin në seminarin konsultativ.

Përveç të qenit një mjet për të kuptuar profilin dhe natyrën e punës së organizatave pjesëmarrëse, pyetësori online u përqendrua kryesisht në identifikimin e fushave tematike që organizatat i konsiderojnë të rëndësishme për misionin e tyre dhe aktivitetet aktuale. Të anketuarve iu lejua të listonin deri në 5 fusha prioritare, nga 15 temat e listuara. Bazuar në përgjigjet e marra, prioritizimi i fushave të listuara është si më poshtë:

Fusha prioritare	Përqindja
Rinia	58%
Arsimi	41,9%
Vullnetarizmi	36%
Përfshirja sociale	34,9%
Mbrojtja e mjedisit	32,6%
Pajtimi dhe marrëdhëniet ndëretnike	27,9%
Barazia gjinore	27,9%
Ndërmarrësia sociale	26,7%
Mbrojtja e fëmijëve	20,9%
Lufta kundër dhunës me bazë gjinore	16,3%
Sundimi i ligjit / Lufta kundër korrupsionit	16,3%
Energjia e qëndrueshme	15,1 %
Qeverisja e hapur dhe reformat administrative	9,3%
Shëndeti dhe siguria në punë	8,1%
Mbrojtja e konsumatorit	5,8%
Fuqizimi i procesit të zgjedhjeve	4,7%

Gjetjet nga grupet punuese

Organizatorët, në konsultime të përbashkëta me Zyrën e BE-së dhe pjesëmarrësit, i bashkuan fushat prioritare të listuara në 7 tema. Secila nga këto tema u diskutua tërësisht në 7 grupe punuese. Diskutimet në grupet punuese u udhëhoqën nga 7 lehtësues dhe secili prej tyre duhej të ndiqte strukturën e njëjtë të diskutimeve, bazuar në një model të paracaktuar. Gjetjet nga diskutimet e grupeve punuese janë përmbledhur më poshtë:

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: rinia pasive, ndjenja e ulët e solidaritetit, apatia e përgjithshme, mundësitë e ulëta të punësimit, stagnimi në zhvillim, mungesa e vetëdijes dhe mundësitë e kufizuara për zhvillimin e vullnetarizmit, mungesa e projekteve për vullnetarët dhe politikave stimuluese, si dhe infrastruktura e dobët dhe mangësitë ligjore.

Nga ana tjetër, sa i përket vullnetarizmit, ai njihet dhe mësohet si koncept, por nuk inkurajohet dhe çmohet mjaftueshëm si vlerë, e as nuk është pjesë e kulturës shoqërore. Disa nga pengesat kryesore në këtë drejtim janë: mungesa e fondeve dhe mungesa e njohurive mbi rëndësinë e vullnetarizmit nga ana e institucioneve.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: Organizatat e shoqërisë civile, mediat, të rinjtë; sektori publik (institucionet qendrore dhe komunale); sektori privat (bizneset); aktorët e jashtëm (organizatat ndërkombëtare, donatorët).

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: Hulumtimi i vullnetarizmit (infrastruktura ligjore, fondet, vullnetarizmi si koncept, vlerë dhe pjesë e kulturës shoqërore; mekanizmat); krijimi i një rrjeti të OJQ-ve dhe zhvillimi i modeleve të bashkëpunimit dhe partneriteteve; hartimi i një plani strategjik kombëtar; fushata dhe aktivitete të formave të ndryshme për të rritur vetëdijesimin për temat: diskutime, tryeza të rrumbullakëta, përdorimi i rrjeteve sociale, bashkëpunimi me mediat dhe publikimi i videove vetëdijesuese.

Grupi 2:

ARSIMI DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuara nga ky grup punues ishin: infrastruktura shkollore, mungesa e arsimit, cilësia e arsimit, kufizimet financiare sidomos në zonat rurale (ka nxënës që lënë shkollën për shkak të mungesave financiare), mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore private dhe publike. Për më tepër, pjesëmarrësit konsiderojnë se vlerat tradicionale shpesh shkaktajnë konflikte mes prindërve dhe nxënësve, çka pengon funksionimin e trekëndëshit shkollë-nxënës-prind.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: Qeveria, Komuna, Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Mësimdhënësve, Sektori Privat, Shoqatat, Psikologët dhe Punëtorët Socialë.

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: Avokimi për përmirësimin e kushteve, transportit, higjienës dhe ujit të pijshëm në të gjitha shkollat; Identifikimi i (statistikave) fëmijëve që rrezikojnë largimin nga shkolla, çka kërkon nxjerrjen e statistikave se fëmijët rrezikojnë të ndërpresin arsimimin për arsye të ndryshme, veçanërisht financiare; duhet të forcohet puna e inspektoratit për monitorimin e mësimdhënësve; vazhdimi i trajnimeve për mësimdhënësit për të qenë më inovativ në mësimdhënie, çka mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit.

Grupi 3:

SHËRBIMET SOCIALE

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: mungesa e informacionit për përkrahjen financiare të aktiviteteve sociale, mungesa e mekanizmave mes sektorit publik, OJQ-ve private dhe donatorëve; dhe ndikimi politik në formalizimin e institucioneve informale. U nënvizua se ka nevojë që komunat të kontraktojnë OJQ-të e specializuara për shërbimet sociale. Probleme të tjera të identifikuar ishin: qëndrueshmëria e shërbimeve sociale, mosfunksionimi i bordit për licencimin e personave që ofrojnë shërbime sociale, thirrje për projekte me hark kohor të kufizuar për grupet e caktuara dhe qëndrueshmëria e shërbimeve sociale. Gjithashtu, grupi konsideroi se niveli komunal nuk ka vija të posaçme për shërbimet sociale për grupet e cënueshme, kurse OJQ-ve u mungon vullneti për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: Qeveria Qendrore (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave, MBPZHR, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë) - Niveli komunal (Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, QAP).

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: Puna për ofrimin e informacionit (fushatat ndërgjegjëse për mbledhjen e fondeve në shërbimet sociale), ndërtimi i kapaciteteve për personat që ofrojnë shërbime sociale (trajnime, trajnime profesionale), avokim dhe lobim i gjerë, mentorim i personave që ofrojnë shërbime sociale, si dhe rrjetëzim. Po ashtu, u vlerësua se është e nevojshme të krijohen mekanizma koordinues dhe bashkëpunues për shërbimet sociale në Kosovë, për të rritur vetëdijesimin për pagesat e shërbimeve sociale dhe për të krijuar fonde për shërbime të qëndrueshme sociale.

EKONOMIA SOCIALE

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: numri i vogël i ndërmarrjeve sociale; interesi relativisht i ulët për çështjen, papunësia e lartë në grupet e cënueshme, mungesa e zhvillimit të ekonomisë sociale, si dhe në veçanti rregullimi i pamjaftueshëm ligjor. Për më tepër, pjesëmarrësit konsideruan se nuk është bërë mjaftueshëm për konceptimin dhe promovimin e sektorit në përgjithësi. Ndërsa problemet e tjera të identifikuar ishin: mungesa e vetëdijes, transformimi i shpejtë ekonomik; fondet e kufizuara; dhe burimet e kufizuara njerëzore.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: OShC-të, Qeveria, Donatorët, Misionet e Huaja, Komunitetet Lokale, Këshillat e Lagjeve dhe Korporatat.

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: përmirësimi i legjislacionit përkatës, investimi në ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve të cilat punojnë ose janë të interesuara të punojnë në këtë fushë. Për më tepër, pjesëmarrësit konsideruan se mund të punonin bashkërisht në ngritjen e vetëdijes për këtë çështje dhe hartimin e një fushate strategjike. Gjithashtu, krijimi i një Qendre Kombëtare për Ndërmarrjet Sociale u vlerësua si masë që mund të sillte rezultate të prekshme.

Grupi 5:

MBROJTJA E MJEDISIT / MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETËSIA

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: Keqmenaxhimi i mbeturinave, mungesa e edukimit dhe vetëdijesimit të përgjithshëm, mosrespektimi i legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave, llogaridhënia qytetare dhe politike dhe deponitë ilegale, mungesa e shërbimit dhe mungesa e infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave; mungesa e ndarjes së mbeturinave - zbatimit të 3R; mungesa e planeve për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimi i planeve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave. Për më tepër, pjesëmarrësit gjithashtu konsideruan se probleme të tjera në këtë fushë janë: mungesa e qëndrueshmërisë financiare të OJQ-ve dhe mungesa e kapaciteteve nga cilado prej organizatave që mund të hyjnë në partneritet.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: partitë politike, institucionet përkatëse, (MMPH, AVUK) OJQ, Bizneset, Donatorët, Amvisëritë, qytetarët, kompanitë e menaxhimit të mbeturinave (publike dhe private).

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: ngritja e vetëdijesimit të konsumatorëve (të drejtat, detyrimet, interesat dhe dinjiteti), hartimi i rregulloreve të menaxhimit të mbeturinave, monitorimi i planeve të menaxhimit të mbeturinave, ndarja e mbeturinave në burim, prodhimi i energjisë përmes metodës së gazifikimit. Pjesëmarrësit konsideruan se ka nevojë për angazhim në zgjerimin e shërbimeve dhe kompostimin potencial të mbeturinave organike. Gjithashtu, ka mundësi për punë të përbashkët për sa i përket kontributit në harmonizimin e programeve dhe strategjive zhvillimore në sektorin publik-privat dhe civil, si dhe për krijimin e partneriteteve bazuar në përvojën e ndonjë organizate partnere.

Grupi 6:

PAJTIMI DHE DIALOGU KULTUROR

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: media - në aspektin që shpesh është promotor negativ dhe jo gjithmonë është e pranishme kur diçka diskutohet siç duhet. Për më tepër, mediat janë mjaft të pranishme në rastet kur ka incidente apo episode. Nga ana tjetër, grupet konsiderojnë se stereotipet janë shumë të pranishme, jo vetëm mes komuniteteve serbe dhe shqiptare. Janë edhe çështjet gjuhësore, pasi ka shumë të rinj të interesuar për të bashkëpunuar, por adoleshentët nuk e njohin gjuhën e njëri-tjetrit. Megjithatë, për fat të mirë, shumica e të rinjve flasin anglisht, veçanërisht në komunitetin shqiptar. Për më tepër, OSHC-të shpesh nuk mendojnë në terma afatgjatë, prandaj është mirë të përcillen apo të monitorohen dhe të vazhdohet të përmirësohen stagnimet e identifikuar. Mungesa e sinqeritetit është faktori kryesor për një projekt apo veprimtari të suksesshme. Sa i përket temës, të gjitha idetë janë shteruar, kërkohet kreativitet në këtë fushë, në mënyrë që të stimulohen të rinjtë dhe të jenë pjesë e diskutimit të kësaj natyre. Ka edhe frikë dhe mungesë besimi, si dhe çështje të identitetit, sepse komunitetet janë të ndjeshme në aspektin e identitetit, çka çon në mungesë të komunikimit. Institucionet nuk sigurojnë përkrahje për palët e tjera të interesit në këtë temë. Ndërsa OSHC-të nuk janë të koordinuara mirë dhe zëri i tyre nuk është dëgjuar shumë.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: Media, qytetarët, shoqëria civile, institucionet lokale dhe qendrore.

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat: Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: Inkurajimi i qytetarëve përmes grupeve formale dhe informale. Është gjithashtu e rëndësishme të punohet në krijimin e një terreni të favorshëm për të lehtësuar komunikimin mes grupeve të ndryshme. Në fund të fundit, grupet konsideruan se është e nevojshme të krijohet një infrastrukturë për punë praktike për të rinjtë nga komunitetet, përmes krijimit të projekteve më tërheqëse dhe kreative.

Grupi 7:

DEMOKRACIA DHE QEVERISJA E MIRË

§ Problemet:

Problemet kryesore të identifikuar nga ky grup punues ishin: mungesa e transparencës dhe llogaridhënies dhe mospërfshirja e OSHC-ve në procesin vendimmarrës dhe llogaridhënës vendor, si dhe organizatat e shoqërisë civile me kapacitet të kufizuar për të qenë aktive në nivel lokal. Në disa komuna ka mungesë të legjislacionit adekuat (mungesa e legjislacionit të unifikuar për përfshirjen e qytetarëve në të gjitha komunat) ose moszbatimi i legjislacionit edhe aty ku ekziston. Probleme të tjera të identifikuar janë: mungesa e vullnetit politik për përfshirjen e OSHC-ve dhe qytetarëve, pasi ka shumë komuna që kryejnë konsultime publike me qytetarët sa për formalitet. Për më tepër, nuk ka bashkëpunim të strukturuar mes qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile. Megjithatë, ekzistojnë organizata të orientuara drejt individëve që përpiqen të arrijnë bashkëpunimin me nivelin komunal. Edhe në ato raste, mungon kapaciteti dhe mungesa e vetëdijes për konsultimet publike dhe rëndësinë e tyre. Për më tepër, shumica e organizatave nuk kanë kapacitet për të dhënë komente substanciale dhe profesionale.

§ Aktorët:

Aktorët kryesorë të identifikuar ishin: Komunitat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ministritë e linjës që punojnë drejtpërdrejt me komunitat, legjislatura dhe ekzekutivi, organizatat e shoqërisë civile, këshillat lokale, komitetet konsultative, grupet informale, KVRL, bizneset dhe shoqatat e komunave.

§ Veprimet që mund të ndërmerren nga organizatat:

Për sa u përket veprimeve që mund të ndërmerren bashkërisht nga organizatat, u identifikuan veprimet e mëposhtme: konsultimi publik dhe ndarja e granteve për OSHC-të, trajnime; monitorimi i legjislacionit, monitorimi i vendimeve të kryetarit, monitorimi i prokurimeve publike, lehtësimi i debateve buxhetore për komunën, avokimi për buxhetimin gjinor, avokimi për përmbushjen e rekomandimeve të auditorit, promovimi i kodit të etikës për përfaqësuesit e zgjedhur. Gjithashtu, rritja e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre në aspektin e pjesëmarrjes publike dhe krijimi i një rrjeti të këshillave lokale për të ndarë përvojat e tyre të avokimit me komunën. Së fundi, puna për unifikimin e legjislacionit dhe shkëmbimi i përvojave të mira nëpër komuna, ndërkohë që investohet në ngritjen e kapaciteteve të këshillave të fshatit.

Pjesëmarrësit në punëtori

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Organizata
1	Afërdita Mehaj	ZBEK
2	Afërdita Pustina	OSBE
3	Afrim Maliqi	Handikos
4	Alban Maliqi	NOPM
5	Albesa Aliu	FIQ
6	Ana Larderet	Play International Kosovo
7	Ardiana Çela Baraku	SHE-ERA
8	Arieta Dragusha	FIQ
9	Bedri Berisha	Agjencia për Zhvillim dhe Inovacion
10	Berzat Berzati	Rajoni i Gorës
11	Besnik Rustemi	SWOK Kosovo
12	Betime Hoxha	IKS
13	Bujar Kadriu	KDF
14	Chester Eng	Korpusi i Paqes Kosovë
15	Damir Bajrami	ICEC
16	Dardan Abazi	INDEP
17	Dardan Kryeziu	CIVIKOS
18	Dario Di Benedetto	ZBEK
19	Dea Isufi	Kosovo CSR Network
20	Destan Berisha	IQTD
21	Driton Bajraktari	KFSE
22	Egzon Mustafa	CEDE
23	Erik Mackinley	Rotary Prishtina
24	Fatir Berzati	Durchhalten
25	Helena Poucki	GAIA
26	Ivo Gjokiq	MDNZ
27	Kenan Beqiri	CMB
28	Lavdim Istrefaj	OJQ Rinia
29	Linda Shuku	BGF
30	Lorika Tahiri	KAMA
31	Merisa Abdullahu	FIQ
32	Mevlude Murtezi	CIPOF
33	Mumin Ahmeti	EKOS - SANI
34	Musa Vezgishi	PHRC
35	Emri dhe Mbiemri	Organizata
36	Ngadhnjesa Bresa	Ozoni
37	Nita Rudi	KDF
38	Nurten Demiri	ZBEK
39	Qëndrim Hoxha	LDA

40	Refik Kasi	ICEC
41	Rezarta Tahiraj Islami	OJQ STAY
42	Ricardo Celeghini	RTM
43	Salih Shehu	OJQ Shqiponja
44	Selatin Kaçaniku	KONSUMATORI
45	Shemsije Seferi	OJQ Alma
46	Shpend Sopu	EKOvizioni
47	Shukrije Lecaj	Caritas Switzerland
48	Slobodan Vujicic	Udruzenje Crnogoraca Kosovo
49	Tahire Gashi	NGO Zana
50	Urim Veselaj	TBF
51	Urim Xharavina	LDIP
52	Valentina Zefi	RTM
53	Vehbi Guxholi	OJQ Gjeomjedisi
55	Vjosa Morina	IE
56	Zana Hoxha	INDEP

Fotografi nga punëtorja



Raporti i përgatitur nga: FIQ dhe INDEP